



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2728/4 prot.

Datë 23.11.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1220/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.11.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshuar*”, me Nr. REF-83912-10-16-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e sistemeve të parkimeve”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 1,254,400 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK, me NIPT M31904013D, me adresë: Rruga e Dibrës, Njësia Administrative Nr.8, Vila Nr.153, kati i parë, ZK nr.8360, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier  
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.10.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshuar”, me Nr. REF-83912-10-16-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e sistemeve të parkimeve”, (marrëveshje kuadër), me fond limit 1,254,400 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datë 27.10.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 31.10.2023, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. QuantX IT Solutions SHPK	1.252.800 lekë	skualifikuar
-----------------------------	----------------	--------------

Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: *“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “QuantX IT Solution” SHPK, me NUIS M31904013D, konstatoi mangësit si më poshtë:*

*Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në pikën 2.2.1, përcaktohet se:*

*”Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:*

*2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se 400 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor...”*

*Operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm shkresën zyrtare nr.1265 prot., datë 19.10.2023, të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesëve, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve për periudhën Janar-Shtator 2023. Pra, periudhë e cila nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.2.1 të Shtojcës 8 të DST-së (të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore), kërkuar nga autoriteti kontraktor.*

*Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha*

*kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e “QuantX IT Solution” SHPK skualifikohet..”*

II.4. Në datën 02.11.2023, autoriteti kontraktor ka anuluar procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 07.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3574 si dhe nr. protokollit 2728/2023 datë 07.11.2023, e operatorit ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, lidhur me skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht: “[...] Rezulton se AK Bashkia Fier, si pjesë e dokumentave të tenderit të procedurë së prokurimit publik objekt i këtij ankimi, ka publikuar Kërkesat e Vecanta për Kualifikim, Shtojca 8, pika 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, ku në nënpikën 2.2.1 përcaktohet se:

*"Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre përpërbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:*

*2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se 400 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim."*

*Rezulton se OE QuantX IT Solutions në përmbushje të kësaj kërkesë ka paraqitur në SPE vërtetimin e xhiros, si pjesë e dokumentave faktike "vërtetim xhiro QuantX IT.pdf", dokumenti nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Nr. 1265.Prot datë 19/10/2023 ku konfirmohet nga autoriteti tatimor që xhiro e subejtit QuantX IT Solutions për periudhën koherente është 46,330,499 Lekë (dyzet e gjashtë milion e treqind e tridhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë).*

*Pra duke u bazuar për sa më lart, vlera e xhiros së OE QuantX IT Solutions është rreth 115 herë më e lartë sesa kërkesa përkatëse në DST nënpika 2.2.1, pra e përmbush në më shumë se një herë këtë kërkesë për kualifikim.*

*Edhe vetë KPP, si organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimit publik, në vendimin Nr.201/2021 datë 12/05/2021, ka mbajtur të njëjtin qëndrim që vërtetimi i xhiros kërkohet më qëllim që AK të ketë një panoramë të qartë të aftësive dhe kapaciteteve zbatuese të OE ofertues dhe xhiro kërkohet sipas nja sasive të caktuar që OE QuantX IT Solutions e plotëson në më shumë se një herë*

*.Nëse do ti referohemi parashikimeve ligjore në fuqi, konkretisht Ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", për vërtetimin e xhiros, citohet se:Neni 77 Kërkesat për kualifikim 3. Në*

*lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*

*Pra, referuar qëllimit të normës juridike, kërkesa për vërtetimin e xhiros shërben që ti ofrojë AK sigurinë e mjaftueshme bazuar në shkresë që OE ofertues ka realizuar aktivitet ekonomik të mjaftueshëm.*

*Gjithashtu edhe referuar argumentimit të vetë AK, në procesverbalin e argumentimit të publikuar në SPE, argumentimi për vërtetimin e xhiros është si vijon:*

*"Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën sic është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës."*

*Pra rezulton e provuar që vërtetimi i xhiros i paraqitur nga QuantX IT Solutions shpk përmbush kriterin e vendosur nga AK në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe duke siguruar AK për aftësinë e OE.*

*Theksojmë nga ana tjetër që skualifikimi nga KVO në AK Bashkia Fier të ofertës së OE QuantX IT Solutions shpk, është një vendim jo proporcional dhe në kundërshtim me kornizën e përgjithshme ligjore të veprimtarisë së organit publik.*

*Në zbatim të Kodit të Procedurave Administrative në RSH, neni 14, citoj:*

*Neni 14*

*Parimi i objektivitetit*

*Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative. .*

*Në respektim të këtij parimi të veprimtarisë së organeve publike, duhet që AK të vlerësojë me drejtësi të gjitha provat dhe faktet e paraqitura, duke u nisur nga qëllimi i AK që është realizimi i një procedure prokurimi publik në mënyrë të rregullt dhe nënshkrimi i kontratës.*

*Nga ana tjetër duhet patur parasysh se kjo procedurë prokurimi publik është e llojit "Procedurë e hapur e thjeshtuar", procedurë prokurimi e konceptuar nga ligjvënësi për të inkurajuar pjesëmarrjen në procedurat e prokurimit publik të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Normalisht, shumë biznese, nisin si ndërmarrja të vogla dhe pasja e një eksperience mbi 3 vjetecare nuk është gjithmonë e arritshme, por ky fakt nuk do të thotë që kanë mungesë eksperience apo nuk mund të realizojnë një kontratë publike.*

*Për të matur eksperiencën, shërbejnë indikatorë të tjerë si objekti i aktivitetit, dokumentat që vërtetojnë se ka kryer punë/shërbime të ngjashme, dëshmi kualifikimi dhe certifikime, sasia e xhiros e realizuar në njësinë e caktuar të kohës që jo domosdoshmërisht është 3 vite. Në rastin konkret, OE QuantX IT Solutions shpk ka realizuar më shumë xhiro në njësinë e kohës, sesa OE e tjerë me të njëjtën fushë aktiviteti të llogaritur në dy vite kalendarike.*

*Prandaj akti i skualifikimit nga AK Bashkia Fier, përveqse është një skualifikim i padrejtë për QuantX IT Solutions, nga ana tjetër dekurajon edhe OE e tjerë të marrin pjesë në procedurat e prokurimit publik dhe ky fakt nuk i shërbën aspak qëllimeve të legjislacionit. Për të konkluduar QuantX IT Solutions shpk në vazhdim të arsyetimit të paraqitur më lart, i gjykon më se të drejta e të ligjshme pretendimet e paraqitura.*

*Për sa kemi paraqitur më sipër, në dritën e fakteve, bazuar në legjislacionin përkatës, përfundimisht kërkohet:*

- 1. Pranimin e ankesës sonë.*
- 2. Oferta e QuantX IT Solutions shpk të kualifikohet si e suksesshme*
- 3. Të anulohet vendimi i AK për anulimin e procedurës së tenderit*
- 4. Të vijohet me hapat me hapat e mëpasshme dhe nënshkrimin e kontratës me QuantX IT Solutions shpk. [...]”.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 2728/2 datë 08.11.2023, lidhur me kërkesën e operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK mbi shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe anulimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave për anulimin e procedurës së prokurimit .

II.7. Me shkresën nr. 9053/13 prot, datë 10.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2728/3 datë 13.11.2023 me objekt: “Dërgohet vendimi i KSHA në lidhje me ankesën.....”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni mbi procedurën e prokurimit dhe vendimi i KSHA nr.9053/12, datë 10.11.2023 lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi, sipas të cilit është vendosur mospranimi i ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

## **Arsyeton:**

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “QuantX IT Solution” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “QuantX IT Solution” SHPK, me NUIS M31904013D, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, në pikën 2.2.1, përcaktohet se:

”Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se 400 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor...”

Operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm shkresën zyrtare nr.1265 prot., datë 19.10.2023, të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesëve, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ku ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve për periudhën Janar-Shtator 2023. Pra, periudhë e cila nuk përputhet me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.2.1 të Shtojcës 8 të DST-së (të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore), kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, mbështetur në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, neni 92, pika 3, ku shprehimisht përcaktohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit”, oferta e “QuantX IT Solution” SHPK skualifikohet..” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7/2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka përcakruar kriterin si më poshtë:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (2021, 2022) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më pak se 400 000 lekë pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare

*konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “QuantX IT Solution” SHPK, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë vijon:

- Vërtetim nr.1265 prot, datë 19.10.2023 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me përmbajtje si më poshtë:

*Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. çështje E0001151286 datë 03.10.2023 ju bëjmë me dije se tatimpaguesi person fizik/juridik QuantX IT Solutions me NIPT M31904013D, me administrator Z/Zj. Dorjana Mehmeti dhe me objekt aktiviteti: Riparimi i kompjuterave dhe paisjeve periferike....etj në bazë të dhënave të situatës financiare të paraqitur në vitet e mëposhtme, ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave / shërbimeve si më poshtë:*

<i>Periudha</i>	<i>Me numra</i>	<i>Me shifra</i>
<i>Janar-Shtator 2023</i>	<i>46.330.499 lekë</i>	<i>(dyzetë e gjashtëmilion e treqindetridhjetë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë )lekë</i>

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*



3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se:

“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

*Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor. [...].*

*Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK konstatohet, se ky i fundit ka paraqitur Vërtetim nr.1265 prot, datë 19.10.2023, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, në të cilin pasqyrohet xhiroja e vitit 2023 të subjektit “QuantX IT Solutions” SHPK. Referuar ekstraktit të regjistrimit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit rezulton, se operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK është regjistruar si shoqëri tregtare në datën 03.07.2023 dhe dokumentacioni që ka paraqitur i përket vitit 2023. Në këto kushte, mungesa e xhiros vjetore për vitet 2021 dhe 2022 nuk mund të konsiderohet shkak për skualifikimin e këtij operatori ekonomik, pasi për vitin 2023, xhiroja e shoqërisë rezulton më e madhe se kërkesa e autoritetit kontraktor. Pra, që të quhej i përmbushur kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK duhet të plotësojë kërkesën e autoritetit kontraktor për të paktën një vit nga tre vitet e fundit, ndërkohë që operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK e përmbush dhe e tejkalon kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën shtojcën 7, pika 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi vlera e xhiros për vitin 2023 është 46.330.499 lekë, pra shumë herë më e madhe se vlera e kërkuar nga autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

*rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-83912-10-16-2023, me objekt: “Mirëmbajtje e sistemeve të parkimeve”, me fond limit 1,254,400 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 27.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**